



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 463, DATË 22.9.2011,  
“PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në pikën 3, të nenit 22, pas fjalës “ndalon”, shtohet togfjalëshi “...ose kufizon ...”.

**Neni 2**

Në nenin 48, "Ndalimi i importeve dhe kalimeve transit të mbetjeve", bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 riformulohet si më poshtë vijon:

"1. Ndalohet në të gjitha rastet importimi i mbetjeve të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë."

b) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë vijon:

"3. Ndalohet importi i mbetjeve jo të rrezikshme, për qëllim ruajtjeje ose asgjësimi në Republikën e Shqipërisë."

### **Neni 3**

Pas nenit 48, shtohet neni 49 me përmbajtje si më poshtë vijon:

1. Në Republikën e Shqipërisë importohen vetëm mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte, përveç atyre të përcaktuara në pikën 3 të nenit 48 të këtij ligji.

2. Importimi i mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij ligji, është i mundur vetëm me autorizim të ministrit.

3. Kërkesa për autorizimin e importit paraqitet në ministri.

4. Autorizimi i importit të mbetjeve jo të rrezikshme lëshohet vetëm në përputhje të plotë me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi.

5. Autorizimi për importin e mbetjeve jo të rrezikshme është i vlefshëm për një periudhë kohe deri në dy vjet dhe i nënshtrohet kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në rregulloret e miratuara në zbatim të këtij ligji, si dhe çdo kushti specifik që lidhet me rastin konkret.

6. Në autorizimin e importimit të mbetjeve përcaktohen:

a) lloji i mbetjeve për importin e të cilave lëshohet;

b) standardet që lidhen me ambalazimin dhe etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre;

c) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e lëvizjeve të mbetjeve.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton listën e mbetjeve që lejohen të importohen dhe rregullat për zbatimin e këtij neni.

8. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat dhe procedurat, për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim, për zbatimin e këtij neni.

### **Neni 3**

Në nenin 62 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 48 riformulohet si më poshtë:

"48. Çdo person që importon mbetje të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë."

b) Pas pikës 50 shtohet pika 51 me përmbajtje si më poshtë vijon;

" 51. Çdo person, që importon mbetje jo të rrezikshme në territorin e Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin dhe jo në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

#### **Neni 4**

#### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktin nënligjore në zbatim të pikës 8 të nenit 3 të këtij ligji.

#### **Neni 5**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**ILIR META**

GRUPI I DEPUTETËVE PROPOZUES:

1. EDUARD SHALSI

2. ERDIT BUSHATI

3. Bujar Sejdiu ~~Qazimi~~



4.

5.

6.

7.

8.

9.

10.

11.

12.

13.

14.

15.

16.